



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



Shkresë	23.04.2025
Nga:	ZPP Gentiana Qela
PER:	PRO MEDICAL SH.P.K
Lenda :	VENDIM

Në pajtim me nenin 108/A, paragrafi 10, nën paragrafi 10.2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068 si dhe Ligjin 04/L-237 si dhe Ligjin nr. 05/L-092 si dhe Rregullores (A01) nr. 002/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "PRO MEDICAL SH.P.K të datës 18.04.2025 kundër njoftimit për kontratë për procedure të prokurimit me numër 611-25-2674-2-2-1, me titull " Mirembajtja e paisjeve mjeksore - Aparaturave Laboratorike ne QKMF" datës 02.04.2025 , Komuna e Drenasit (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit sjell:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "PRO MEDICAL SH.P.K të datës 15.04.2025 kundër njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimit me numër 611-25-2674-2-2-1 me titull " Mirembajtja e paisjeve mjeksore - Aparaturave Laboratorike ne QKMF" e datës 02.04.2025
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdojë me njoftimin për kontratë të projektit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "PRO MEDICAL SH.P.K.. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike e-prokurimi në adresën <http://e-prokurimi.rks-gov.net>
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Kerkesa:1

5. Dëshmi për së paku 2 serviserë të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve laboratorike (pa specifikuar

marka apo modele të caktuara)

Pergjigja:

Bazuar ne referncat e dërguara nga Ju për kontratat e lidhura me disa institucione shihen emrat e aparaturave ekzistuese sikur edhe ne paramasën e QKMF ne Drenas

Andaj kërkojmë çertifikues ose kontrata te lidhura me çertifikues adekuat për aparaturat e cekura në paramasë.

Kerkesa:2

1.Deklaratë që dëshmon se pjesët rezervë që ndërrohen janë origjinale ose të barasvlershme me origjinalin (me origjinë nga prodhuesi), me garanci minimale 12 muaj.

Pergjigja:

Duke llogaritur se këto janë pajisje elektronike të cilat ndikojnë drejtëpërdrejtë në rezultatet e analizave, kërkojmë që pjesët e ndrrimit të janë origjinale dhe kjo kërkesë refuzohet ne tërësi

Kunder ketij vendimi keni te drejte ankese ne OSHP ne afate prej 10 Dite .